

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ATOM transport” Sh.p.k

Ne Durres, sot me date 10 Dhjetor 2024 (dymije e njezete e kater), personat e meposhtem:

- Znj.Kreiza Meço, shtetase shqiptare, lindur në Tirane më 18/04/1986 dhe banues në Tirane, identifikuar me mjet identifikimi me nr personal I65418073P
- Znj.Fitore Albani, shtetase britanike, lindur në Ferizaj më 06/06/1979 dhe banues në Londer, identifikuar me mjet identifikimi me nr pashaporte 124671241

te cilet, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ATOM transport” Sh.p.k

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaku themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te Shoqerise, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjetere.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte “ATOM transport” Sh.p.k

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit dhe Aktit te Themelimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Veprimtaria e Shoqerisë “ATOM transport” Sh.p.k do të ketë për objekt :

Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash per vete dhe te trete.



Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion ekonomik që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

Per te realizuar qellimet e saj Shoqëria mund te siguroje dhe perdore financime nga vende te tjera ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në baze të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5

Selia

Selia e Shoqërisë "ATOM transport" Sh.p.k është në adresën:

Lagja "Porto Romano", Pasuria me Nr. 15/5, Zk 3339, Durrës

Neni 6

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10 000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)
Kreiza Meço	50	1
Fitore Albani	50	1

Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota me vlerën 10,000 leke.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

Neni 8

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem me nje mandat 3(tre) vjecar.

- Administratori i pare i shoqerise eshte :
- Znj.Kreiza Meço, shtetase shqiptare, lindur në Tirane më 18/04/1986 dhe banues në Tirane, identifikuar me mjet identifikimi me nr personal I65418073P
- Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

Neni 9

Te ardhurat

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se vitit ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 10

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, eshte hartuar ne 4 kopje ne gjuhen Shqipe.

ORTAKET THEMELUES:

Kreiza Meço



Fitore Albani

